



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 54

Prishtinë, më 28.2.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi.

Munguan : Daut Haradinaj, Liburn Aliu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MMPH, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 20.02.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbeturina,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime dhe u miratua prezantimi i shkurtë nga Luan Hasanaj-Drejtor për iniciativën qytetare “ta pastrojmë Kosovën”.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.2.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 20.2.2012.

Para se të shqyrtohet rendi ditës kryetari **Nait Hasani** ja dha fjalën z. Luan Hasanaj-drejtor, rreth prezantimit të iniciativës qytetare “ta pastrojmë Kosovën” për datën 24.5.2012.

Luan Hasanaj falënderoj për ftesën dhe fillimisht sqaroi se fjala është për një iniciativë globale në 100 shtetet brenda globit tokësor. Kjo iniciativë ka filluar në Estoni, vazhdoi, nga një grup i të rinjve më 2008 dhe prej atij momenti është bërë një ngjarje botërore kur janë mbledhur 10.000 ton mbeturina brenda ditës. Kjo ka vazhduar në Lituanë më 2010 dhe Slloveni etj dhe njëherit ka përkrahje të madhe nga Parlamenti Evropian. Procesi në Kosovë është në vazhdim e sipër dhe ka arrit të zbatohet në 17 komuna dhe kemi të bëjmë me fushatë. Me 24 maj 2012 është dita e pastrimit të Kosovës. **Afërdita Berisha** tha se 24 maji është ditë pune, pse ?, drejtori u përgjigj dhe tha se duhet të jetë ditë aktive punuese, gjithashtu shtoi se aktivitetet do të jenë vullnetare pa asnjë pagë të vetme, mirëpo megjithatë do të ketë kosto. Vullnetarja prezente **Agime Gashi** tha se qëllimi është që dikush në Kosovë të ngritët, të mbledhë mbeturina dhe të bëjmë diçka të vlefshme ose natyrshme. **Salih Morina** njoftoi dhe inkurajoi drejtorin se mund të aplikojnë në Komisionin Evropian për projekte të tilla ngase do të përkrahen me siguri, ngase ky komision kishte një vizitë në Sarajevë me parlamentarët evropian ku janë premtuar ndihma të ngjashme. Drejtori Hasanaj tha se procedurat në KE janë të rënda por do të insistohet patjetër me aplikime, gjithashtu premtoi se kjo iniciativë do të mbetet si tradicionale edhe në Kosovë dhe apeloj që komisioni të publikoj sa më lartë këtë apel të iniciativës qytetare “ta pastrojmë Kosovën” më 24 maj 2012. Ai gjithashtu kërkoi nga komisioni të ndikoi te MMPH dhe MBPZHR për përkrahje sa më të madhe, sidomos për aktivitetin që atë ditë të mbjellët nga një fidan në çdo vend ku punohet. **Valbona Puka** nga Ombudspersoni sqaroi se problemi i dhënies së fidanëve nuk është problemi kyç ngase ato i jap Instituti në Pejë, por çështja kryesore është mirëmbajtja e tyre nga Komuna, për çka duhet të negociohet me zyrtarët komunal.

Nait Hasani në emër të Komisionit falënderoi dhe premtoi përkrahjen në nivelin më të lartë.

3. Shqyrtimi i projektligjit për Mbeturina

Nait Hasani përshëndeti zyrtarët nga MMPH dhe ekspertin Behxhet Shala dhe filloi shqyrtimin e projektligjit nga neni 5 aty ku ka mbetur komisioni në mbledhjen e fundit. Pasi që u përmirësuan në disa vende vërejtjet e ekspertit, komisioni ndërpreu mbledhjen për të vazhduar nesër tek neni 14 i projektligjit. Kryetari sugjeroi që në mbledhjen e nesërme të marrin pjesë përveç ministrit të MMPH edhe zyrtarët nga asociacioni i komunave të Kosovës.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani